

EKSTRAKT NGA INTERVISTA

[Intervista e gjatë e historisë gojore me narratoren u realizua më 16 maj, 2021 në Prishtinë. Me kërkesën e narratores për anonimitet, ne kemi fshehur identitetin.]

Intervistuesja: Kur ke fillu me punu?

Narratorja: Valla, kom fillu prej moshës 30 vjeçare.

Intervistuesja: *Uh* {onomatope} edhe qysh ka qenë?

Narratorja: Po ka qenë, shumë jom konë e lumtur kur kom fillu me punu që më kanë liru për shembull, që më ka dhonë leje burri. Pse? Se s’e kom pa të arsyshme, pse shembull une mos me shku ni punë me krejt, pse mos me shku? Une qajo që jom konë gjithëhere isha, kudo që jom e njejta, pse...?

Intervistuesja: E pse u duhshe me vet burrin?

Narratorja: U dehshe me vet se atëherë qashtu, pa të dhonë leje burri s’ke mujt me shku kërkun, s’ke pasë drejtë. Sepse nashta ish ardhë puna dej te problemi edhe pa qare u dashtë me e ulë kryet edhe qysh ta ka dhonë komandën burri. Po i thashë, “Une du me punu, se boll ka shku koha pa punë e krejt”, “Jo” tha, “ti s’ki nevojë” tha, “gratë e tona s’kanë nevojë me punu, se na punojna”. “Po ti punon, po unë për veti du me punu, për fëmi tem, për jetën, për krejt, pse me nejt kur e du punën edhe jom e punës”. Po ma vonë ka ndryshu edhe e ka pa që normale osht’ ajo, duhet me punu, puna duhet. Edhe më ka leju, ja kom fillu me punu, tash kurrë s’ma merr mendja m’u nalë, as hiç.

Intervistuesja: E kallxom, qysh ka qenë puna juve e parë?

Narratorja: Po puna jem shumë e knaqne jom konë, kur ja kom fillu punës shumë e knaqne. Po thom, që e kom dashtë punën gjithë, s’kom mujt me ja arritë qëllimin kurrë edhe m’u ka dok se ni jetë tjetër krejt a edhe sot më doket. Se më dhimet qajo kohë që më ka kalu pa punë. Pse s’u konë në rregull ajo,

pse, pse mos me punu femra kur don me punu? E ni veten shumë ma mirë që punoj. Edhe pse s'kena mujt me ja arritë qëllimin me u shkollue, e me do punë tjera m'u marr, ma lehtë diçka ma mirë. Po edhe kjo s'osht' keq, kur e di që s'kena punu kurgjo, shembull jena marrë veç me punë të shpisë, je martu e ke prit musafirin, je marrë me do sene shumë të kota, a po kupton? A për vetveten, qysh me thonë, s'ke pasë nashta mundësi ni kafe me dalë me pi. A krejt punët i ke bo, si je çu prej mëngjesit e deri në mramje je munu me respektu krejt qat familje, farefisnin krejt, po kur u ardhë puna për me dalë e kështu nuk ke mujt m'u knaq kurrë.

Kom fillu te motra në restoran, e ka pasë në Milloshevë, po sezona, s'ka pasë punë gjatë dimnit puna u ra edhe u dashtë m'u largu me gjetë punë tjetërkun. Se s'kanë mujt ata, shembull qato pagesa me ja u bo, shembull punëtorëve që i kanë pasë edhe s'ke pasë çka ju bon edhe u dashtë m'u tërhjekë. E në restoran kom hekuros mbulesa edhe te bina nusës jom konë kryesore, se jom konë qysh me thonë, gjithërë jom konë për punë kështu përfekt. Kom pasë qef taman mirë me bo edhe unë jom konë kryesore aty.

Intervistuesja: Çfarë detyra ke pasë qaty?

Narratorja: Kom pasë m'i pastru mbulesat, m'i hekuros edhe po thom kryesore jom konë te bina nusës që unë i kom kry ato krejt.

Intervistuesja: E aty çka ka?

Narratorja: Aty ka mbulesa e tavolinës te dhondrri, te çifti edhe mrapa osht' perdet ato dekorimet ato çka don m'i ba dikush. Ka ndodhë që edhe prej familjes, qasaj familjes që e ka bo darsmën i kanë pru, të vetat kanë dashtë. Jo çka kanë pasë këta të restoranit, shembull, po kanë dashtë me bo edhe ma mirë i kanë pasë mundësitë, tani u dashtë edhe qato m'i pastru, m'i hekuros çka kanë dashtë ata, çfarë dëshira kanë pasë u dashtë me ja u plotësu tamam.

Intervistuesja: A të pëlqejke qajo?

Narratorja: Po, s'e kom pasë problem, se na jena konë punëtoore edhe ven kena bo gjithkunj. Edhe jom konë shumë e knaqne s'e kom nije lodhjen. Veç kom thonë krejt tjetër jetë, krejt, çfarë ndryshimi, me gjithë vullnetin tem jom nisë edhe jom kthye. Tash mu ka dokë ni jetë krejt tjetër. Une po të thom që punës kështu s'ju kom tutë kurrë, edhe kom thonë pse kjo e bon edhe une kom me bo. E bon, shembull dikush e unë s'muj e boj, jo kom me bo edhe une, se une jom vetvetja edhe kom mujt me bo. Po nifarë stresi që ku po shkoj, mos po kom fjalë, mos nuk po i pëlqen edhe pse motra thojke, "Kujt moj s'i pëlqen ti?" Thojsha, "E nuk i dihet ka, gjithçka ka, nashta mundohesh për mirë po ta keqpërdor najkush edhe qe të largon nashti". "Jo moj" thojke, "ti ven ki gjithkund. Se na që jemi të punës" thojke, "gjithë vend bojna", a din?

Intervistuesja: Nuk osht' ndjenjë e lehtë me hi në shpi dikujna...

Narratorja: Shumë osht' problem, shumë me stres, kur kom fillue domethonë në qat' moshë, në qat' kohë shumë me stres. Se kom thonë ku po shkoj, po domethonë me propozimin e dikujna që e kom ditë në familje tamon, se gjithkunj parja s'ja vlen për mu. Nuk osht' gjithçka, kurrë as s'ka mu konë. Se pa e njoftë ni familje taman kështu me rrojë s'kom pranë me shku. Po ajo që ma ka gjetë tamon e ka ditë sigurtë çfarë familje më ka thonë. "Të njoh çfarë femne je edhe bon, se m'u konë që s'bon nuk të thom".

Intervistuesja: E kallxom qysh e bon marrëveshjen? Me konë mirresh vesh?

Narratorja: Po marrëveshjen, marrëveshjen shembull me ndërmjetësuse. Ka shoqe që kom të qasaj ane, tash sot jonë të martume në qytet e njohin dikun, lidhje mas lidhje. Ju thotë dikush, e kërkon naj punëto. Normal që gjithkush kërkon punëtoren e mirë edhe të sjellshme. Edhe i thotë që, "A e kije dikunin se qishtu, qishtu" shembull bash qetash e kom ni ofertë, ishin zyrtar te banesat e arabëve. Edhe më thirri shoqja më tha, "A don me shku, se kishin thonë që, 'Kurrë punëtore taman të mire s'kena pasë. A e kije ti najkon me na gjetë? E ka ni orar të plotë, e ka pagën qekaq. Po nëse na pëlqen, nëse osht' qysh po thue ti, se dimë as vet, kena m'i ndihmue shumë asaj, asaj grupe". Kur të shkoj tash aty, e asaj osht' me m'i tregu krejt çka kom, çfarë pune, m'i thonë krejt me kohë. "Edhe unë po t'i tregoj të mijat edhe ti tuat që mos me pasë fjalë se due tamon..." a din?

Intervistuesja: Po de, për qato po thom, kallxona qysh...

Narratorja: Po, "Due tamon m'u konë e knaqne ti edhe une. Po, ti mos e nifsh veten të knaqne, atëherë une largohna vet. Veç ni fjalë ki me ma thonë, 'Qitu s'po më pëlqen edhe u kry'. Po une në mundësi të mia, ki me ma vlerësu punën ti edhe po ja filloj". Ata gjithherë ku jom shku, jonë konë të knaqun shumë. Edhe e kom ni une veten shumë mirë.

Intervistuesja: Sa orë zakonisht punon?

Narratorja: Po zakonisht kom punu me tetë orë. Po qetashti jom me ni orar të shkurtë, po këta kanë thonë që i kem zyrtar te Komuna e re edhe mas ni kohë, mas ni viti, tash po bohet ni vit në gusht. "Mas ni viti kena me dalë atje, e ki orarin e plotë, e kije pagën kuptohet taman, qishtu edhe e kije orarin taman", a din?

Intervistuesja: Çfare janë detyrat e zakonshme tuat, çka kryen?

Narratorja: Po detyrat e mia të zakonshme jonë mirëmbajtja, dritaret, komplet çka ka nevojë, tavolinat, krejt çka të ka nevojë krejt i kryj. Nuk ka pasë nevojë, shembull asni fjalë me ma thonë që, "Qeto s'e ke bo", po gjithçka në rregull u konë edhe më kanë thonë, "Shumë mirë".

Intervistuesja: A ke pasë najherë kontratë për punën që e ke bo?

Narratorja: Kurrë.

Intervistuesja: Qysh nihesh për këtë sen?

Narratorja: Kurrë. Ka ndodhë kur kom shku në Fushë Kosovë te këta si e kanë “BauMarketin” kom punu, ju kom thonë, “A bon me kontratë me ma bo?” Se krejt marketet çka i kanë, krejt punëtorët i kanë me kontratë, pse veç ti m’u konë e ndame, shembull. E nashti une e kom bo, jo nashti po punën e kom bo, puna ju ka pëlqy krejt edhe jom marrë vesh me atë zojën e shpisë i kom thonë, “A bon?” Ka thonë, “Bon, po nëse pranon me t’i nda shembull prej pagës tonde mujore, atëhere bon...” bon për shembull 25 euro, 30, sa osht’ me rregull? Edhe kom thonë, apet s’kom pranu se s’e ke pasë ni pagë ku me ditë sa edhe atëherë domethonë që i ke pasë nevojat e shpisë edhe nashta s’ke mujt me i kry, veç do çka janë të rëndësishme edhe s’ke pasë qysh, po. Edhe e kom lonë për jo... apet, apet kom vazhdu qashtu pa letra, pa...